



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 02/08/2022 Ref.: 1035/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 103-të mbajtur më 26.07.2022, mori:

V E N D I M

- I. Korrigohet vendimi 1575/20 dt.11.09.2020 me të cilin Validohet programi i studimit i RIT Kosovo (A.U.K.) College për periudhën 1 Tetor 2020 - 31 Shtator 2023. Korrigjimi bëhet në pikën I dhe ka të bëjë me numrin e studentëve, kështu që në paragrafin ku shkruan;
 - Informatikë dhe Teknologjitë Informative, BSc, 240 ECTS, **maksimum 50 studentë për vit akademik**, korrigohet dhe ndryshohet numri në **maksimum 140 studentë për vit akademik**.
- II. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

RIT Kosovo (A.U.K.) College me datë 19.07.2022 ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për rritjen e numrit të studentëve në programin e studimeve ● Informatikë dhe Teknologjitë Informative, BSc, 240 ECTS, nga **maksimum 50 studentë për vit akademik**, në **200 student për vit akademik**.

Meqenëse RIT Kosovo (A.U.K.) bazuar në Udhëzimin administrativ (MASHT) 08/2018 për ndrysimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ nr.15.2018, nuk i nënshtrohet procesit të vlerësimit për akreditim nga AKA dhe duke marr për bazë validimin e këtij institucioni nga agjencia "The Middle States Commission on Higher Education", e cila është anëtare e Komitetit të Arsimit të Lartë (CHEA) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, KShC bazuar në kompetencat dhe fushën e përgjegjësisë si dhe rrethanat e reja të paraqitura në kërkesës, vendosi për korrigjim të vendimit 1575/20 dt.11.09.2020 për ndryshimin e numrit të studentëve si në pikën I të dispozitivit, bazuar në aplikacionin fillestar të RIT Kosovo (A.U.K.) dhe validimin e vitit 2020.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 103-të mbajtur më 26.07.2022 ka shqyrtuar kërkesën e RIT Kosovo (A.U.K.) College dhe arsyet e cekura në kërkesë, vlerësimin, validimin nga agjencia "The Middle

States Commission on Higher Education", bazuar në nenin 50 të Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- RIT Kosovo (A. U.K.);
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasni Hazi
Kryetare e Këshillit Shërbor të Cilësisë

